

Njoftim për të drejtat e punëmarrësit: Leje për arsye Sigurie dhe Shëndetësore

Ju keni të drejtën e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore, si dhe të drejtën e lejes së paguar të paralindjes. Ju e keni këtë të drejtë pavarësisht nga statusi juaj i imigracionit. Punëdhënësi juaj duhet t'ju japë këtë njoftim duke ju shpjeguar të drejtat tuaja.

Periudha e lejes:

Leje për arsye Sigurie dhe Shëndetësore (kujdesi për veten ose këdo që konsideroni si familjar)	Leje e paguar e paralindjes (kujdes shëndetësor për veten gjatë shtatzënisë)
<ul style="list-style-type: none">Të gjithë punëdhënësit duhet të ofrojnë deri në 40 orë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore çdo vit kalendarik.Punëdhënësit me 100 apo më shumë punonjës duhet të ofrojnë deri në 56 orë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore çdo vit kalendarik. <p><i>Punonjësit me kohë të plotë dhe të pjesshme përfitojnë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore me një normë prej 1 orë për çdo 30 orë të kryera pune.</i></p>	<ul style="list-style-type: none">Të gjithë punëdhënësit duhet të ofrojnë një periudhë shtesë prej 20 orësh leje të paguar të paralindjes.

Viti kalendarik i punëdhënësit tuaj është: _____ deri në _____
Muaji i parë Muaji i fundit

Ju keni të drejtën e lejes së **PAGUAR** për arsye sigurie dhe shëndetësore nëse:

- Punëdhënësi juaj ka 5 apo më shumë punonjës.
 - Punëdhënësi juaj ka më pak se 5 punonjës por ka të ardhura neto prej 1 milion dollarësh apo më shumë.
 - Ju punoni si një punëtor/e shtëpiak/e në shtëpinë e dikujt; për shembull, dado, kujdestar/e i/e shtëpisë, apo punonjës/e shoqërimi.
- Shënim: Ligji mbulon 1 apo më shumë punëtorë shtëpiakë që punojnë në një shtëpi.*

Ju keni të drejtën e lejes të **PAPAGUAR** për arsye sigurie dhe shëndetësore nëse:

- Punëdhënësi juaj ka më pak se 5 punonjës por ka të ardhura neto më pak se 1 milion dollarë.

Ju mund të mbartni orë leje të papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore në vitin pasues kalendarik.

Përdorimi i lejes për arsye Sigurie dhe Shëndetësore:

- Përdoreni për shëndetin tuaj, duke përfshirë marrjen e kujdesit shëndetësor apo për t'u rikuperuar nga një sëmundje apo dëmtim.
- Përdoreni për t'u kujdesur për një anëtar të familjes që është sëmurë apo ka një takim me mjekun.
- Përdoreni kur puna juaj apo shkolla e fëmijës tuaj mbyllet për shkak të një emergjence të shëndetit publik.
- Përdoreni atë për sigurinë tuaj ose për sigurinë e një anëtari të familjes për shkak të dhunës në familje, kontakteve të padëshiruara seksuale, ndjekjes apo trafikimit njerëzor.

Punëdhënësi juaj mund t'ju kërkojë ta njoftoni paraprakisht për përdorimin e planifikuar të lejes; për shembull, për të marrë pjesë në një takim të caktuar me mjekun apo në një seancë gjyqësore. Ju nuk duhet ta njoftoni paraprakisht për një përdorim të papritur të lejes; për shembull, sëmundje ose një urgjencë mjekësore.

Ju gëzoni të drejtën për privatësi. Ju nuk duhet t'i jepni punëdhënësit tuaj detaje se pse keni përdorur lejen tuaj.

Nëse përdorni më shumë se tre ditë pune radhazi të lejes, punëdhënësi juaj mund t'ju kërkojë dokumentacion.

Deklaratat e kërkuara me shkrim:

Punëdhënësi juaj duhet:

- T'ju japë një rregullore me shkrim që shpjegon se si të përdorni përfitimet tuaja.
- T'ju tregojë sa leje keni përdorur dhe sa ju ka mbetur për çdo periudhë page.

Jo Hakmarrje:

Është e paligjshme të ndëshkosh ose pushosh nga puna punonjësit për kërkimin ose përdorimin e lejes apo për raportimin e shkeljeve.



Kontakttoni Mbrojtësin e Konsumatorit dhe Punonjësve për të mësuar më shumë ose për të paraqitur një ankesë.

Vizitoni nyc.gov/workers | Telefononi 311 dhe pyesni për "Lejen e paguar për arsye Sigurie dhe Shëndetësore"

Ju gjithashtu mund të bëni një raportim ANONIM.